

**AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË "ORGITO TRAVEL" SH.P.K**

Sot më datë 01/04/2024:

- **Z. Pashk Kola**, me numër ID I91224033G i datëlindjes 24/12/1989 lindur në Livadhëz, Mirditë dhe banues në Lezhë, Shqipëri.

shpreh vullnetin e tij për hartimin e këtij Akti Themelimi të Shoqërisë "**Orgito Travel**" sh.p.k si më poshtë vijon:

1. Forma ligjore e shoqërisë

Shoqëria "**Orgito Travel**" sh.p.k, nga këtu e më poshtë në këtë akt, e referuar si shoqëria, themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar", shkurtimisht sh.p.k.

2. Ortakët themelues

Shoqëria është themeluar nga Ortaku i vetëm:

- **Z. Pashk Kola**, me numër ID I91224033G i datëlindjes 24/12/1989 lindur në Livadhëz, Mirditë dhe banues në Lezhë, Shqipëri.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i aktivitetit të shoqërisë "**Orgito Travel**" Sh.p.k do të jetë:

1. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar i udhëtarëve me autobus;
2. Transport kombëtar dhe ndërkombëtar i mallrave të ndryshme me autobus për të tretë dhe me qera;
3. Shit-blerje dhe dhënie me qera e automjeteve të ndryshme;
4. Çdo aktivitet tjetër i lejuar me ligj.

4. Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë "**Orgito Travel**" Sh.p.k. do të jetë në Lezhë, në adresën: Lagjia "Besëlidhja", Rruga "Gjergji Fishta", Ndërtesa nr. 25, Kati i parë, Lezhë, Shqipëri.

Shoqëria mund të vendosë të hapë degë, filiale apo zyra përfaqësie në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë saj.



5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj, sipas objektit, për një periudhë të papërcaktuar nga data e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar.

6. Kapitali i shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 500,000 Lekë (pesëqind mijë lekë).

E gjithë pjesa e kapitalit themeltar është nënshkruar në tërësinë e saj nga Ortaku themelues.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet edhe me kontribute në natyrë.

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themelor të Shoqërisë bëhet me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Fondi në të holla që vjen nga shlyerja e pjesëve të kapitalit themeltar depozitohet për llogari të Shoqërisë në të gjitha Bankat që ndodhen në territorin e Shqipërisë.

7. Drejtimi dhe Administrimi

Shoqëria drejtohet nga Asambleja e Ortakëve dhe Administratori.

Administratori i parë i shoqërisë “**Orgito Travel**” sh.p.k është Z. Pashk Kola me nr. ID 191224033G.


Administratori emërohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve, për një periudhë jo më shumë se 5 vjet.

Përfaqësimi i shoqërisë tregtare “**Orgito Travel**” sh.p.k në marrëdhënie me të tretët dhe brenda kufijve që i njej ligji dhe Statuti, i përket Administratorit të saj. Ai ka të drejtë të përfaqësojë Shoqërinë edhe në organet gjyqësore apo të ngarkojnë për këtë qëllim një zyrë avokatie në mbrojtje të interesave të Shoqërisë.

8. Shpërbërja dhe likuidimi

Shpërbërja dhe likuidimi i shoqërisë tregtare mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak ligjor, duke përfshirë dhe falimentimin, privimin për të ushtruar profesion tregtar, forca madhore, rast lufte dhe të çdo faktori tjetër që nuk varet nga vullneti i ortakëve të shoqërisë.

Ortaku i shoqërisë “Orgito Travel” sh.p.k


Z. Pashk Kola